

KARTA

E ETIKËS DHE E SJELLJES

Parimet e etikës profesionale
të paraqitura në kartë duhet të
frymëzojnë sjelljen tonë, në të gjitha
rrethanat dhe në të gjitha vendet.



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	4
BINDJET TONA	6
Ne jemi një grup privat i dobisë publike	6
Objektivi ynë është performanca e përgjithshme	6
Ne besojmë në vlerat humaniste	6
Modeli ynë menaxherial është garanti i kohezionit tonë	7
Sukseset e vërteta janë sukseset e përbashkëta	7
ANGAZHIMET TONA	8
Social	8
Mjedisi	10
Novacioni	10
RREGULLAT TONA	11
Respektim i ligjshmërisë	11
Respektimi i personave dhe i të drejtave të njeriut	12
E drejta e konkurrencës	13
Lufta kundër korrupsionit	13
Agjentët tregtarë	14
Financimi i veprimtarive politike	14
Parandalimi i konflikteve të interesit	15
Komunikimi dhe informimi	15
Mbrojtja e aseteve	16
Sistemet e komunikimit	16
Transparenca dhe kontrolli i brendshëm	16
Operacionet financiare	17
ZBATIMI	18
Mekanizmi i alarmit profesional	18
Ndëshkimet	18

PARATHËNIE



VINCI është ngritur rreth vlerave të fuqishme që formësojnë kulturën tonë dhe drejojnë veprimet tona. Për shumicën nga ne, këto vlera janë të nënkuptuara dhe ne i shprehim ato gojarisht. Në një grup që përfshin disa mijëra bashkëpunëtorë të rinj çdo vit, është e rëndësishme që këto të shprehen qartë. Ky është misioni i parë i këtij dokumenti që i fton të gjithë bashkëpunëtorët e Grupit të tregojnë vigjilencë shumë të madhe për sa i përket zbatimit siç duhet të kësaj Karte.

Përtej bindjeve dhe angazhimeve që na bashkojnë, kam dashur të formalizoj tërësinë e rregullave të sjelljes që janë të detyrueshme për të gjitha ndërmarrjet tona dhe për të gjithë bashkëpunëtorët tanë. Këto rregulla nuk janë të reja. Ato figurojnë rregullisht në direktivat e përgjithshme që u dërgoj drejtuesve të qendrave të profesioneve të VINCI-t. Çdo qendër ka marrë masat për të siguruar respektimin e tyre duke zhvilluar sistemin e saj të kontrollit të brendshëm. Ato përcillen në të gjitha nivelet hierarkike në njësitë operative, veçanërisht pranë çdo përgjegjësi të ri kur ai merr detyrën. Kjo Kartë i shpjegon këto rregulla për tërësinë e bashkëpunëtorëve tanë – por edhe për publikun tonë të jashtëm.

Përmes kësaj Karte, ne nuk kujtojmë vetëm që përkatësia në grupin VINCI nënkupton një respektim të rreptë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Ne afirmojmë parimet e etikës profesionale që duhet, në të gjitha rastet dhe në të gjitha vendet, të frymëzojnë sjelljet tona. Ne pohojmë se VINCI pret nga çdo bashkëpunëtor një sjellje të paqortueshme, të bazuar në ndershmërinë, besnikërinë, respektimin e dinjitetit dhe të të drejtave individuale të punonjësve.

Këto rregulla janë shqyrtuar dhe miratuar nga komiteti Ekzekutiv i VINCI-t. Përveç shpërndarjes së tyre në intranetin e VINCI-t dhe në faqen tonë të internetit, i ftoj të gjitha qendrat tona të profesioneve t'i përhapin ato gjerësisht pranë ekipeve sipas formës që do t'u duket më efikase për të siguruar respektimin e tyre, duke i plotësuar, nëse është e nevojshme, në varësi të veçantive të veprimtarive dhe të vendeve të interesuara.

Performanca personale e secilit prej drejtuesve të grupit VINCI do të vlerësohet veçanërisht në bazë të respektimit të këtyre rregullave nga ekipi që ai është ngarkuar të udhëheqë ose të drejtojë.

Në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe auditin, mund të kryhen kontrole të befasishme me iniciativë të Grupit në plotësim të mekanizmave të ngritur në qendrat e profesioneve.

Referenti etik i VINCI-t kujdeset, në bashkëpunim me drejtoritë operative ose funksionale, për kuptimin e saktë të kësaj Karte. Çdo bashkëpunëtor që has vështirësi ose ka pyetje mbi përcaktimin ose zbatimin e këtyre rregullave mund të këshillohet me të drejtpërdrejt dhe në konfidencialitet të plotë.

Kam besim te secili prej jush për përvetësimin e tyre. Në këtë mënyrë VINCI do të vazhdojë të frymëzojë besimin e klientëve të tij publikë dhe privatë, të partnerëve, të aksionarëve dhe të bashkëpunëtorëve të tij. Kështu do të jemi besnikë ndaj vlerave që na bashkojnë.

Xavier Huillard,
president-drejtor i përgjithshëm i VINCI

BINDJET TONA

Ne jemi një grup privat i dobisë publike

Biznesi i VINCI-t është të financojë, konceptojë, ndërtojë dhe menaxhojë pajisje të dobishme për komunitetin dhe jetën e secilit: infrastruktura transporti, ndërtesa publike dhe private, rregullim urban, rrjete energjie dhe komunikacioni.

Ky biznes e bën VINCI-n një aktor të rëndësishëm në rregullimin e Qytetit dhe në zhvillimin e territoreve. VINCI e ushtron atë duke e vënë performancën e tij si grup privat në shërbim të misionëve të tij të interesit të përgjithshëm. Ai kombinon kështu sfidat afatshkurtra të veprimtarisë së ndërmarrjeve të tij me sfidat afatgjata të realizimeve dhe të modelit afatgjatë si koncesionar-ndërtues.

Objektivi ynë është performanca e përgjithshme

Performanca e ndërmarrjeve tona nuk kufizohet vetëm në rezultatet e tyre ekonomike dhe financiare. Objektivi ynë është krijimi i vlerës së përgjithshme. Puna jonë si rregullues i Qytetit dhe territoreve na detyron të pyesim veten mbi qëllimin dhe dobinë shoqërore të arritjeve tona, duke iu përgjigjur pritshmërive të përdoruesve dhe të komunitetit. Sfidat e ndryshimeve klimatike duhet të na nxisin të zhvillojmë vlerën mjedisore të projekteve tona. Performanca jonë vlerësohet gjithashtu në terma të integritetit të projekteve dhe kantierëve në strukturën e tyre vendore, si dhe të kontributit në zhvillimin ekonomik, social dhe shoqëror.

Ne besojmë në vlerat humaniste

Për VINCI-n, një sukses ekonomik i qëndrueshëm është i pandashëm nga një projekt njerëzor ambicioz.

Vlerat tona të humanizmit janë të rrënjësura në kulturën tonë si ndërtues. Besimi, respekti dhe solidariteti, dhënia e përparësisë njerëzve mbi sistemet, vlerësimi i njëkohshëm i iniciativës personale dhe i punës kolektive, parim bazë i kantierit, janë në qendër të identitetit tonë si sipërmarrës. Këto vlera udhëheqin veprimet dhe sjelljet tona, frymëzojnë menaxhimin tonë dhe organizatat tona. Ato materializohen, kundrejt të gjithë bashkëpunëtorëve tanë, nga politika jonë e zhvillimit të qëndrueshëm – dhe nga angazhimet tona të formalizuara nga Manifesti i Grupit.

Modeli ynë menaxherial është garanti i kohezionit tonë

Përtej larmisë së profesioneve të veta, të territoreve të ndërhyrjes dhe të bashkëpunëtorëve të tij, Grupi karakterizohet nga një mënyrë menaxhimi që është garanti i kohezionit dhe motori i zhvillimit të tij.

Ky model mbështetet në decentralizimin e organizatave, autonominë e njësive operacionale dhe përgjegjësinë e menaxherëve. Besimi që ata gëzojnë është i pandashëm nga parimet e paprekshme të besnikërisë dhe të transparencës.

Ky model favorizon performancën dhe krijimtarinë e çdo bashkëpunëtori brenda kornizës e rregullave të qarta të lojës. Promovimi i iniciativës individuale shkon krah për krah me rrjetëzimin e ekipeve dhe kompetencave, duke favorizuar transversalitetin midis profesioneve dhe funksionimit në formë projekti.

Sukseset e vërteta janë sukseset e përbashkëta

Duke kërkuar performancën globale, duke ndjekur një projekt ekonomik dhe shoqëror afatgjatë, VINCI ka ambicien t'i ndajë sukseset e veta me punonjësit, klientët, aksionarët e tij dhe tërësinë e aktorëve të Qytetit.

ANGAZHIMET TONA



Social

Të kujdesemi për respektimin e të drejtave të njeriut në veprimtaritë tona

VINCI është një grup ndërkombëtar, i pranishëm në një numër në rritje vendesh. Ndërsa konteksti institucional dhe korniza ku vendosen operacionet ndryshojnë ndjeshëm nga njëri vend tek tjetri, ndërmarrjet VINCI duhet të veprojnë në respektim të të drejtave themelore të personave dhe të bashkësive vendore që mund të preken nga projektet.

Si i tillë, VINCI është pajisur me një **Udhërrëfyes të të drejtave të njeriut** që formalizon angazhimet e Grupit në këtë fushë dhe paraqet linjat drejtuese dhe veprimet që duhet të zbatohen nga ndërmarrjet dhe bashkëpunëtorët për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut, pavarësisht nga profesioni dhe vendi i vendosjes.

VINCI, që është anëtarësuar në vitin 2003 në Paktin global të Kombeve të Bashkuara, është angazhuar, në bazë të një qasjeje vullnetare, të respektojë 10 parimet e tij dhe të komunikojë çdo vit mbi nismat e ndërmarra.

Të veprojmë si punëdhënës i përgjegjshëm

VINCI i jep përparësi sa më shpesh që është e mundur krijimit të vendeve të qëndrueshme të punës. Ambicia e tij është të favorizojë zhvillimin profesional të bashkëpunëtorëve të tij duke i propozuar secilit një projekt trajnimi të personalizuar dhe duke u ofruar atyre perspektiva zhvillimi që vënë në pah aftësitë, krijimtarinë dhe energjinë e tyre sipërmarrëse. Menaxhimi parashikues i punësimit dhe i aftësive (GPEC) e shoqëron këtë qasje të përgjegjshme, duke i paraprirë zhvillimit të profesioneve dhe duke identifikuar nevojat për personel dhe njohuri teknike në afat të shkurtër dhe të mesëm.

Përpara rekrutimit, ndërmarrjet e VINCI-t, në bashkëpunim me shkollat dhe aktorët e punësimit, veprojnë për të zhvilluar atraktivitetin e profesioneve të tyre, për të zhvilluar kualifikime, për të favorizuar integritetin profesional dhe kontribuar në zhvillimin e punësimit, veçanërisht pranë të rinjve pa kualifikim dhe personave të larguar nga bota e punës.

Qasja si punëdhënës i përgjegjshëm e VINCI-t shprehet gjithashtu në dialogun shoqëror aktiv me organet përfaqësuese të punonjësve, duke respektuar pavarësinë dhe pluralizmin sindikal.

Të garantojmë sigurinë e çdo bashkëpunëtori

Kujdesi për shëndetin dhe sigurinë në punë të bashkëpunëtorëve të tij është detyra e parë e Grupit.

Objekti i VINCI-t është të arrijë në zero aksidente, si në kantiere ashtu edhe në vendet e veprimtarisë dhe gjatë udhëtimeve. Ky objektiv vlen për bashkëpunëtorët e VINCI-t si dhe për punonjësit e përkohshëm dhe punonjësit e nënkontraktorëve. Ndërmarrjet e Grupit ndërmarrin të gjitha veprimet parandaluese të përshtatshme për arritjen e këtij objekti. Organizimi i trajnimeve për sigurinë të ndjekura nga të gjithë bashkëpunëtorët e një ndërmarrjeje, si dhe masa të tilla si mbledhjet informuese sistematike në fillim të punës kontribuojnë veçanërisht që secili të bëhet aktor i parandalimit në sjelljet e tij të përditshme. Menaxhimi, në të gjitha nivelet hierarkike, përfshihet fort në drejtimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të sigurisë. Rezultatet në këtë fushë bëjnë pjesë në elementet e vlerësimit të performancës së menaxherëve.

Si i tillë, VINCI ka nënshkruar në vitin 2021 me komitetin e evropian të ndërmarrjes një **Deklaratë të përbashkët mbi shëndetin dhe sigurinë në punë**.

Të garantojmë mundësi të barabarta për të gjithë

Parimi i VINCI-t është që të mos diskriminojë, për çfarëdo arsye, në marrjen në punë dhe në marrëdhëniet e punës. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe, më në përgjithësi, marrëdhëniet midis bashkëpunëtorëve bazohen në parimet e besimit dhe të respektit reciprok, me shqetësimin për ta trajtuar secilin me dinjitet.

Përtej rolit të tyre në ngritjen në shoqëri, ndërmarrjet e Grupit ndjekin një politikë voluntariste të menaxhimit të mundësive të barabarta, veçanërisht në drejtim të diversitetit profesional, punësimit të personave me aftësi të kufizuara, të personave me prejardhje nga emigrantët dhe të moshuarve. Ato i verifikojnë rregullisht praktikën në këtë fushë, për të orientuar përpjekjet e tyre për përmirësim. Kuadrot drejtues të VINCI-t janë garantë të zbatimit të kësaj politike. Ata kujdesen t'i përhapin parimet e saj në të tërë zinxhirin menaxherial.

Të ndajmë frytet të rritjes

VINCI inkurajon kthimin e punonjësve në aksionarë dhe individualizimin e pagave duke e vënë theksin mbi përgjegjësitë individuale dhe performancat e çdo bashkëpunëtori. Grupi promovon interesimin dhe pjesëmarrjen e punonjësve në rezultatet e ndërmarrjes së tyre, përmes mekanizmave të përshtatur me kontekstin dhe legjislacionin e çdo vendi.

Të inkurajojmë angazhimin qytetar të punonjësve

Në koherencë me bindjet e tij humaniste dhe vlerat e tij të solidaritetit, VINCI mbështet projektet e qëndrueshme që krijojnë lidhje shoqërore dhe shoqërojnë drejt punësimit personat që janë të përjashtuar prej tij. Këto nisma ndërmerren kryesisht nga Fondacioni VINCI që ofron një kornizë për angazhimin qytetar të bashkëpunëtorëve të Grupit. Fondacioni kombinon sponsorizimin e aftësive, përmes patronazhimit të projekteve nga punonjësit, dhe mbështetjen financiare, të rezervuar për shpenzimet e investimit të shoqatave dhe strukturave të ndihmuara të integritit.

Veprime të sponsorizimit të afërt ndërmerren gjithashtu me nismën e filialeve të Grupit. Këto kontribuojnë kështu, në vijim të kantierëve ose të veprimtarive të tyre, në mbrojtjen e mjedisit, në vlerësimin e trashëgimisë dhe në zhvillimin shoqëror të territoreve të interesuara.

Në asnjë rast, një veprim sponsorizimi nuk mund të ketë si kompensim një avantazh tregtar.



- Udhërrëfyshi i të drejtave të njeriut të VINCI dhe Deklarata e përbashkët mbi shëndetin dhe sigurinë në punë janë në dispozicion të të gjithë bashkëpunëtorëve në intranetin e VINCI-t.





Mjedisi


Të shpalosim një politike të efikasitetit ekologjik

VINCI është plotësisht i ndërgjegjshëm për ndryshimet që nënkupton për ndërmarrjet e tij lufta kundër ndryshimeve klimatike. Grupi vijon riorganizimin e ofertave dhe proceseve të tij, me qëllim që të përfshijë sistematikisht në to zgjidhje me vlerë të shtuar mjedisore. Ai ka vendosur si përparësi zhvillimin e projektimit ekologjik, duke integruar analizën e ciklit të jetës dhe duke i bërë përgjegjës aktorët e ndryshëm të zinxhirit të vlerave, nga projektimi deri në realizimin e punimeve dhe shfrytëzimin. Ai përpunon mjete të krahasimit ekologjik që lejojnë të maksimizohet performanca energjetike e ndërtesave dhe të kufizohet gjurma mjedisore e veprave.

Të zvogëlojmë ndikimin e veprimtarive

Si në veprimtaritë e tij të ndërtimit ashtu edhe në ato të shfrytëzimit, VINCI përpaket të arrijë standardet më të mira mjedisore në fushën e mbrojtjes së burimeve natyrore, të konsumit energjetik, të menaxhimit të mbetjeve dhe të mbrojtjes së biodiversitetit. Zhvillimi i sistemeve të menaxhimit mjedisor, plotësuese të sistemeve të menaxhimit të cilësisë, favorizon një qasje përmirësimi të vazhdueshëm në këtë fushë.

VINCI është angazhuar në të njëjtën kohë në matjen e ndikimeve të tij mjedisore. Mekanizmi i tij i raportimit mjedisor mbulon gati të gjithë xhiron e tij. Grupi mat që prej vitit 2007 emetimet e tij të gazit me efekt serrë, me qëllim që të udhëheqë veprimet që duhen ndërmarrë për kufizimin e tyre dhe që të mundë të masë përparimet e bëra. Përveç përpjekjeve për zvogëlimin e emetimeve të lidhura drejtpërdrejt me veprimtaritë e tij, VINCI përfshin në përpjekjen e tij për përparim partnerët, furnizuesit dhe klientët e tij.



Novacioni

Të inovojmë në mënyrë bashkëpunuese dhe të hapur

Në koherencë me dimensionin e tij si aktor global i planifikimit të qyteteve dhe territoreve, VINCI ndjek një politikë novacioni të orientuar drejt zhvillimit urban, lëvizshmërisë së qëndrueshme, performancës energjetike të ndërtesave dhe infrastrukturave, si dhe transformimit digjital. Në shërbim të projekteve dhe klientëve, novacioni kontribuon gjithashtu në përmirësimin e performancës së ndërmarrjeve dhe në tërheqjen dhe mbajtjen e talenteve. Politika e novacionit ndërthur, nga njëra anë, programet e kërkim-zhvillimit, të kryera në bashkëpunim me aktorët e botës shkencore dhe akademike, nga ana tjetër, një qasje novacioni më operationale që synon të zhvillojë zgjidhje të reja në shërbim të klientëve, sipas metodave bashkëpunuese brenda Grupit dhe me partnerët e tij të jashtëm. Kjo qasje e hapur zbatohet veçanërisht në novacionin digjital, levë madhore e transformimit të ofertave të Grupit.

VINCI ka ngritur mekanizma reflektimi të orientuar drejt së ardhmes, me qëllim që të bashkërendojë në nivel Grupi një mekanizëm gatishmërie dhe identifikimi të tendencave që do të ndikojnë në afat të gjatë kontratat, profesionet dhe veprimtaritë e tij.

RREGULLAT TONA

Çdo bashkëpunëtor i grupit VINCI, pavarësisht nga funksionet dhe niveli i tij hierarkik, duhet të respektojë parimet e sjelljes të përshkruara në këto rregulla.

Këto rregulla nuk kanë për qëllim të zëvendësojnë ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, por të përcaktojnë qëndrime dhe të japin pika referimi që, përtej respektimit të nevojshëm të ligjit, reflektojnë një sjellje personale dhe profesionale shembullore në interes të Grupit.

Ato inkuadrojnë, pa i zëvendësuar, rregullat specifike që mund të ketë miratuar çdo qendër e grupit VINCI për t'iu përmbajtur më mirë ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme në veprimtaritë e veta.

Këto rregulla mund të plotësojnë ose të përforcojnë – por kurrë të minimizojnë – rregullat e hartuara nga qendrat.

Në zbatimin e tyre, secili tregon urtësi dhe ndershmëri. Çdo bashkëpunëtor duhet të marrë njohuri të mjaftueshme mbi rregullat e zbatueshme në veprimtaritë e tij, pavarësisht nga vendi ku ato ushtrohen, me qëllim që të mund të përcaktojë çastin kur bëhet e nevojshme të marrë këshilla pranë hierarkisë dhe shërbimeve kompetente (veçanërisht shërbimet juridike, shërbimet e burimeve njerëzore) të qendrës së tij ose të Grupit.

Nëse këto rregulla rezultojnë të paplota ose të pasakta në disa situata, nëse një bashkëpunëtor ndien një pasiguri ose një dyshim mbi sjelljen që duhet të mbajë në situata të veçanta, ky ftohet të këshillohet me hierarkinë e tij, shërbimet kompetente (shërbimet juridike, shërbimet e burimeve njerëzore ose të tjera) të qendrës së tij ose të Grupit, ose referentin etik të VINCI-t.

Respektim i ligjshmërisë

Ndërmarrjet VINCI dhe bashkëpunëtorët e tyre duhet të respektojnë ligjet dhe rregullat e zbatueshme në të gjitha vendet ku ushtrojnë veprimtaritë e tyre.

Çdo bashkëpunëtor duhet t'ia ndalojë vetes çdo qëndrim që mund ta shtyjë atë vetë ose të shtyjë bashkëpunëtorë të tjerë, ndërmarrjen e tij ose Grupin në një praktikë të paligjshme ose të pandershme. Lidhur me këtë, brenda Grupit, asnjë objektiv performance nuk mund të përcaktohet, imponohet, pranohet ose shpërblehet në çfarëdo lloji forme, nëse realizimi i tij nënkupton shmangien nga këto rregulla.

Dispozitat në vijim nuk kanë si qëllim të paraqesin me hollësi tërësinë e detyrimeve ligjore që mund të zbatohen, por të tërheqin vëmendjen mbi disa rreziqe që kërkojnë vigjilencë të veçantë.

Respektimi i personave dhe i të drejtave të njeriut

Grupi VINCI zbaton një politikë të drejtë të burimeve njerëzore, në përputhje me ligjet dhe që respekton të drejtat e personave dhe liritë individuale dhe kolektive.

Ndalohet veçanërisht çdo diskriminim i bazuar mbi një motiv të paligjshëm si gjinia, mosha, zakonet, përkatësia reale ose e hamendësuar, në një etni ose komb të caktuar, gjendja shëndetësore, handikapi, feja, bindjet politike ose veprimtaritë sindikale.

Çdo presion, përndjekje ose persekutim me karakter moral ose seksual ose më në përgjithësi në kundërshtim me ligjin është i ndaluar.

Ndërmarrjet VINCI respektojnë jetën private të bashkëpunëtorëve dhe të të tretëve. Ndërmarrjet VINCI zbatojnë parimet e transparencës, ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë në lidhje me grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale dhe kujdesen që bashkëpunëtorët të jenë në dijeni të këtyre rregullave dhe t'i zbatojnë ato. Personat e interesuar informohen për qëllimet e përpunimit, mënyrat e aksesit në të dhëna, për të drejtën e tyre për korrigjim, fshirje, kufizim ose kundërshtim të përpunimit. Mbledhja e të dhënave është rreptësisht e kufizuar në të dhënat e nevojshme për qëllimet e përpunimit. Kohëzgjatja e ruajtjes së tyre u përshtatet qëllimeve të çdo përpunimi dhe detyrimeve rregullatore. Janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar nivelin më të mirë të sigurisë dhe të konfidencialitetit të të dhënave personale të mbledhura, me qëllim që të shmangët përhapja e tyre.

Ndërmarrjet VINCI dhe bashkëpunëtorët e tyre angazhohen të shmangin të gjitha masat që shkelin të drejtat e njeriut.

Grupi ka identifikuar pesë fusha, në të cilat veprimtaritë e ndërmarrjeve VINCI mund të kenë ndikime domethënëse në të drejtat e njeriut:

- migrimi i fuqisë punëtore dhe praktikat e marrjes në punë;
- kushtet e punës;
- kushtet e strehimit;
- praktika në lidhje me të drejtat e njeriut në zinxhirin e vlerës;
- komunitetet vendore.

Në secilën prej këtyre fushave linjat drejtuese VINCI mbi të drejtat e njeriut japin rekomandime të qarta dhe të sakta për parandalimin e rreziqeve të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Ndërmarrjet VINCI duhet të kujdesen që bashkëpunëtorët të jenë të trajnuar

Përveç Paktit global të Kombeve të Bashkuara, VINCI aderon në standardet ndërkombëtare në vijim:

- Deklarata universale e të drejtave të njeriut (DUDNJ);
- Parimet drejtuese të Kombeve të Bashkuara në lidhje me ndërmarrjet dhe të drejtat e njeriut;
- Konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO);
- Parimet drejtuese të OCDE për ndërmarrjet shumëkombëshe;
- Pakti ndërkombëtar në lidhje me të drejtat civile dhe politike (PIDCP);
- Pakti ndërkombëtar në lidhje me të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (PIDESC).

për identifikimin e rreziqeve të shkeljes së të drejtave të njeriut. Ato angazhohen gjithashtu të bëjnë bilancin e praktikave të tyre dhe të situatave me rrezik në fushën e tyre të veprimtarisë. Kur identifikohen rreziqe, ndërmarrjet duhet të vënë në jetë veprime që synojnë parandalimin dhe të shoqërojnë menaxhimin e këtyre rreziqeve.

E drejta e konkurrencës

Grupi i ushtron veprimtaritë e tij në vende që, në pjesën më të madhe, kanë miratuar legjislacione që synojnë ndalimin e sulmeve ndaj lojës së lirë të konkurrencës. Këto rregulla, që burojnë veçanërisht nga nenet 101 dhe 102 të traktatit mbi funksionimin e Bashkimit evropian (TFUE), duhet të respektohen me përpikëri.

Sulmet e paligjshme ndaj lojës së lirë të konkurrencës, që nuk tolerohen brenda grupit VINCI pavarësisht nga vendi i interesuar, mund të marrin forma të ndryshme, veçanërisht:

- një marrëveshje nëpërmjet të cilës konkurrentët bien dakord për shembull të pengojnë caktimin e çmimeve përmes lojës së lirë të tregut duke favorizuar në mënyrë artificiale rritjen apo uljen e tyre, të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin ose përparimin teknik, të ndajnë tregjet etj. Një shkëmbim i thjeshtë informacioni midis konkurrentëve, veçanërisht para dorëzimit të ofertave në kuadrin e një tenderi, mundet të gjykohej kështu si e paligjshme, nëse ka si objekt ose si pasojë të pengojë, të kufizojë ose të shtrembërojë lojën e konkurrencës;
- një abuzim me pozicionin dominues me anë të të cilit një ndërmarrje përpiqet të përfitojë nga pozicioni që mban në një treg për të larguar konkurrentët e saj;
- një shfrytëzim abuziv i gjendjes së varësisë ekonomike në të cilën ndodhet një klient ose një furnizues i një ndërmarrjeje kundrejt kësaj të fundit.

Brenda VINCI-t dhe në varësi të veçantive të çdo qendre veprimtarie, duhet të organizohen trajnime për të siguruar kuptimin e mirë të këtyre rregullave nga bashkëpunëtorët e interesuar.

Në këtë drejtim, duhet veçanërisht të kihet kujdes që çdo grupim, edhe i përkohshëm, në të cilin merr pjesë një entitet i VINCI-t, të krijohet dhe të veprojë duke respektuar rregullat e konkurrencës të zbatueshme në vendin e interesuar, dhe duke marrë parasysh interesin e ligjshëm të klientit të interesuar.

Shoqëritë ose drejtuesit e tyre ose bashkëpunëtorët që shkelin këto rregulla do të ekspozohen ndaj dënimeve civile ose penale të rënda, të cilave do t'u shtohen ndëshkimet që mund të vendosë Grupi.

Pra, çdo bashkëpunëtor i VINCI-t duhet t'ia ndalojë vetes çdo sjellje që mund të konsiderohet si praktikë anti-konkurrencë në tregun në të cilin vepron.

Lufta kundër korrupsionit

Dhënia, negocimi dhe ekzekutimi i kontratave publike ose private nuk duhet të shkaktojë sjellje ose veprime që mund të cilësohen si korrupsion aktiv ose pasiv, ose si bashkëpunim në ndikimin e paligjshëm ose bashkëpunim në favorizim.

Asnjë bashkëpunëtor i VINCI-t nuk duhet t'i japë drejtpërdrejt ose tërthorazi një të treti avantazhe të pamërituara, të çfarëdolloj natyre dhe me çfarëdolloj mënyrë, me qëllim që të marrë ose të ruajë një transaksion tregtar ose një trajtim favorizues.

Korrupsioni i agjentëve publikë të huaj në transaksionet tregtare ndërkombëtare është i ndaluar.

Çdo bashkëpunëtor do të shmangë marrëdhëniet me të tretë që mund ta

vendosin atë personalisht në situatë detyrimi dhe mund të bëjnë të lindë dyshimi mbi integritetin e tij. Po kështu, ai do të kujdeset që të mos e ekspozojë ndaj një situatë të tillë një të tretë, të cilin përpiqet ta bindë ose ta nxisë të përfundojë një marrëveshje me një shoqëri të Grupit.

Çdo bashkëpunëtor të cilit do t'i kërkohej një shërbim i tillë, duhet t'ia raportojë këtë hierarkisë së tij, e cila do të marrë të gjitha masat për t'i dhënë fund kësaj situatë.

Dhuratat mund të ofrohen ose pranohen në emër të një shoqërie VINCI vetëm kur vlera e tyre është simbolike ose e ulët duke pasur parasysh rrethanat dhe nëse këto nuk janë të tilla që të bëjnë të dyshohet për ndershmërinë e dhuruesit ose paanësinë e përfituesit.

Çdo bashkëpunëtor duhet t'i referohet **Kodit të sjelljes antikorrupsion** të VINCI-t që formalizon në mënyrë të hollësishme rregullat e zbatueshme në këtë fushë.

Agjentët tregtarë

Ndërmarrjet VINCI nuk përdorin ndërmjetës, të tillë si agjentët tregtarë, konsulentët ose prurësit e biznesit, përveç rasteve kur këta janë në gjendje të sigurojnë një shërbim të ligjshëm, të dobishëm dhe të bazuar në një ekspertizë profesionale specifike. Kjo padyshim përjashton përdorimin e një ndërmjetësi për kryerjen e operacioneve që janë në kundërshtim me ligjin dhe/ose mund të cilësohen si korrupsion.

Ndërmarrjet VINCI duhet të kujdesen që këta persona të mos e komprometojnë Grupin me veprime të paligjshme.

Për këtë qëllim, ato do të kujdesen:

- të zgjedhin me zgjuarsri partnerët e tyre duke pasur parasysh aftësinë dhe reputacionin e tyre, veçanërisht në lidhje me etikën e biznesit;
- të përcaktojnë me saktësi shërbimet e pritura nga këta partnerë dhe shpërblimin që ato meritojnë;
- të sigurohen për realitetin dhe rëndësinë e shërbimeve të kryera dhe koherencën e shpërblimit me shërbimet e dhëna.

Financimi i veprimtarive politike

Grupi u përmbahet ligjeve që ndalojnë ose rregullojnë financimin e partive politike dhe të kandidatëve në zgjedhje. Në këtë kontekst, çdo vendim për të kontribuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në financimin e një veprimtarie politike duhet të miratohet paraprakisht nga drejtoria e përgjithshme e shoqërisë së interesuar, që ka si përgjegjësi ta verifikojë ligjshmërinë dhe të vlerësojë dobinë e saj.

Grupi respekton angazhimet e bashkëpunëtorëve të tij që, si qytetarë, marrin pjesë në jetën publike. Çdo bashkëpunëtor që kontribuon në kuadrin e veprimtarive të tij personale në vendimet e një shteti, të një autoriteti publik ose të një bashkësie vendore, ia ndalon vetes të marrë pjesë në një vendimmarrje që i intereson Grupit ose njërit prej entiteteve të tij.

Çdo bashkëpunëtor i VINCI-t është i detyruar të jetë besnik ndaj Grupit.

Parandalimi i konflikteve të interesit

Secili bashkëpunëtor kujdeset të mos ushtrojë drejtpërdrejt ose tërthorazi veprimtari ose të mos thotë fjalë që mund ta vendosin në një situatë konflikti interesi me Grupin.

Një bashkëpunëtor duhet veçanërisht t'ia ndalojë vetes të mbajë një interes në një ndërmarrje, qoftë kjo kliente, furnizuese ose konkurrente e Grupit, nëse ky investim është i tillë që ndikon në sjelljen e tij në ushtrimin e funksioneve të tij brenda Grupit.

Çdo bashkëpunëtor duhet të marrë me shkrim autorizimin e hierarkisë së tij para se të ndërmarrë në emër të një shoqërie të Grupit një transaksion me një shoqëri, në të cilën ai vetë ose një anëtar i familjes së tij është investues ose drejtues i rëndësishëm.

Asnjë bashkëpunëtor nuk duhet të pranojë një mision ose një punë të propozuar nga një furnizues, një klient ose një konkurrent, i tillë që të ndryshojë performancat e tij ose gjykimin e tij në ushtrimin e funksioneve të tij në Grup.

Kur ata ndeshen, megjithatë, me rrezikun e konfliktit të interesit, bashkëpunëtorët duhet, në një frymë transparence, të informojnë për këtë menjëherë hierarkinë e tyre dhe t'ia ndalojnë vetes çdo përfshirje në marrëdhëniet që Grupi mban me të tretin e interesuar, për aq kohë sa nuk do të jetë gjetur një zgjidhje.

Komunikimi dhe informimi

Grupi i kushton një rëndësi të madhe cilësisë së informacionit dhe kujdeset të zbatojë, veçanërisht ndaj palëve të interesuara, një komunikim transparent dhe të besueshëm.

Menaxhimi i mirë i Grupit kërkon që secili, pavarësisht nga niveli i tij i ndërhyrjes, të kujdeset me rreptësinë më të madhe për cilësinë dhe saktësinë e informacioneve që ai përcjell brenda Grupit.

Një bashkëpunëtor nuk duhet të përhapë jashtë Grupit informacionet konfidenciale që ka për shkak të funksioneve të tij ose rastësisht për shkak të përkatësisë së tij në Grup. Ai nuk mundet as t'u komunikojë informacione konfidenciale bashkëpunëtorëve të Grupit që nuk janë të autorizuar t'i njohin ato.

Informacionet në lidhje me rezultatet, parashikimet dhe të dhëna të tjera financiare, blerjet dhe shitjet, ofertat tregtare, produktet e reja, shërbimet ose njohuritë teknike si dhe me burimet njerëzore duhet të konsiderohen si rreptësisht konfidenciale.

Duke qenë se VINCI është një shoqëri e kuotuar në Bursë, çdo komunikim në drejtim të mediave mund të prekë imazhin dhe reputacionin e tij dhe duhet përgatitur me kujdes. Marrëdhëniet me mediat, investuesit, analistët financiarë dhe organizmat publikë janë përgjegjësi e Drejtorisë së Përgjithshme dhe e drejtorive të Komunikimit ose të Marrëdhënieve me investuesit dhe komunikimin financiar.

Çdo bashkëpunëtor i VINCI-t duhet të mbrojë pronat dhe asetet e Grupit.

Mbrojtja e asetëve

Pronat dhe asetet e Grupit nuk kufizohen vetëm te pronat e luajtshme dhe të paluajtshme. Ato përfshijnë idetë, veprat ose njohuritë e përpunuara nga bashkëpunëtorët e Grupit dhe entitete të VINCI-t, si dhe reputacionin dhe imazhin e Grupit. Listat e klientëve dhe të nënkontraktorëve ose furnizuesve, informacionet mbi tregjet, praktikatat teknike ose tregtare, ofertat ose studimet teknike, dhe më në përgjithësi të gjitha të dhënat ose informacionet në të cilat bashkëpunëtorët kanë qasje gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, janë pjesë e pasurisë së Grupit.

Detyra e mbrojtjes së saj vazhdon pavarësisht nga largimi i një bashkëpunëtori.

Asnjë bashkëpunëtor nuk përvetëson për përdorimin e tij personal një aset çfarëdo të Grupit, as nuk e vë në atë dispozicion të të tretëve për një përdorim në përfitim të personave të tjerë jashtë Grupit.

Sistemet e komunikimit

Sistemet e komunikimit dhe rrjetet intranet janë pronë e Grupit dhe përdoren për qëllime profesionale. Përdorimi për qëllime personale autorizohet vetëm nëse vendoset brenda kufijve të arsyeshëm, nëse justifikohet nga nevoja për një ekuilibër të drejtë midis jetës private dhe jetës profesionale dhe rezulton i nevojshëm. Ndalohet përdorimi i sistemeve të komunikimit dhe rrjeteve informatike për qëllime të paligjshme, veçanërisht për të përcjellë mesazhe me karakter racist, seksual ose fyes.

Secili ia ndalon vetes të bëjë kopje të paligjshme të mjeteve informatike të përdorura nga Grupi ose t'i përdorë në mënyrë të paautorizuar këto mjete.

VINCI ka zhvilluar një **Udhërrëfyes të përdoruesve të burimeve të Sistemit të Informacionit**, që përcakton:

- rregullat e përgjithshme të përdorimit të Burimeve informatike;
- ndalimet dhe pikat e vigjilencës në lidhje me përdorimin e internetit, të postës elektronike, të mjeteve "nomade" (kompjuterë, asistentë personalë digjitalë...), materiale, programe dhe aplikacione të vëna në dispozicion nga ndërmarrja;
- parimet e mbrojtjes dhe të kontrollit që mund të vendosen.

Transparenca dhe kontrolli i brendshëm

Çdo bashkëpunëtor merr pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të rrezikut dhe lehtëson identifikimin dhe trajtimin e mosfunksionimeve. Secili kontribuon me kujdes dhe zell në sondazhet, kontrollet dhe auditet e kryera në kuadrin e kontrollit të brendshëm.

Operacionet dhe transaksionet që kryhen nga Grupi regjistrohen në mënyrë të sinqertë dhe besnike në llogaritë e çdo shoqërie, në përputhje me rregulloret në fuqi dhe me procedurat e brendshme. Çdo bashkëpunëtor që kryen regjistrime kontabël tregon saktësi dhe ndershmëri dhe sigurohet për ekzistencën e dokumentacionit përkatës për çdo hyrje. Çdo transferim fondesh kërkon një vigjilencë të veçantë, sidomos lidhur me identitetin e marrësit dhe arsyen e transferimit.



Çdo pengesë për kryerjen siç duhet të kontroleve dhe auditeve, qoftë kur bëhen nga shërbimet e brendshme, ose nga ekspertët kontabël, ose të tretët e autorizuar rregullisht nga autoritetet publike, si dhe çdo fshehje informacioni në këtë kuadër janë të ndaluara dhe përbëjnë shkelje të rënda të këtyre rregullave.

Operacionet financiare

Transaksionet që kryejnë bashkëpunëtorët në tregjet bursiere, si kur është fjala për transaksione të kryera për shkak të funksionit të tyre ose për transaksione personale mbi titujt e kuotuar të Grupit, respektojnë ligjet dhe rregulloret që drejtojnë veprimtaritë financiare.

Përhapja e informacioneve të pasakta, komunikimi dhe përdorimi i informacioneve të privileguara si dhe manipulimi i kurseve janë objekt i ndëshkimeve penale.

I përket veçanërisht çdo bashkëpunëtori të kujdeset për konfidencialitetin e çdo informacioni jopublik që mund të ndikojë në kursin e aksionit VINCI ose çdo titulli tjetër të kuotuar të Grupit, deri në botimin e tij nga personat e autorizuar. Po ashtu, çdo bashkëpunëtor ia ndalon vetes kryerjen e operacioneve mbi aksionin VINCI ose çdo titull tjetër të Grupit për aq kohë sa informacioni që mund të ndikojë kursin e tij dhe për të cilin ai ka dijeni, nuk është bërë publik. Përdorimi i informacioneve të tilla për të realizuar një përfitim personal, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ose për t'i lejuar një të treti të kryejë një operacion bursier, ndalohet dhe dënohet me ndëshkime penale.



- **Kodi i sjelljes antikorrupsion i VINCI-t dhe Udhërrëfyesi i përdoruesve të burimeve të Sistemit të Informacionit është në dispozicion të të gjithë bashkëpunëtorëve në intranetin e VINCI-t.**



ZBATIMI

Çdo entitet i Grupit ka përgjegjësinë t'i zbatojë këto rregulla etike, në varësi të detyrimeve dhe veçantive të veprimtarisë së vet ose vendosjes së tij gjeografike. Respektimi dhe zbatimi i këtyre rregullave janë të detyrueshme për të gjithë bashkëpunëtorët, sipas funksioneve dhe përgjegjësi të tyre. Secili duhet të jetë vigjilent për veten e tij, por edhe për ata përreth tij, në ekipin e tij ose ndaj personave që janë nën përgjegjësinë e tij.

Mekanizmi i alarmit profesional

Nëse një bashkëpunëtor dëshiron të raportojë në lidhje me ekzistencën e sjelljeve ose situatave në kundërshtim me këto rregulla, ai mund të përdorë mekanizmin e alarmit profesional që mund të jetë ngritur në entitetin të cilit i përket, ose mekanizmin e alarmit profesional të Grupit, në respektim të ligjit dhe të rregullave të zbatueshme në vendin në të cilin ai banon ose ushtron veprimtaritë e tij.

Ndëshkimet

Kujtohet që këto rregulla, që janë shqyrtuar dhe miratuar nga komiteti Ekzekutiv i VINCI-t, janë të detyrueshme, dhe që askush brenda Grupit nuk mund të përjashtohet nga to, pavarësisht nga niveli i tij hierarkik.

Çdo mosrespektim i mundshëm i këtyre rregullave nga një bashkëpunëtor do të ishte një gabim dhe mund të ishte objekt ndëshkimesh dhe ndjekjesh të përshtatshme nga ana e punëdhënësit të tij brenda Grupit.

Ndëshkimet dhe ndjekjet e përshtatshme janë ato që parashikon e drejta e zbatueshme për bashkëpunëtorin e interesuar dhe që merren në respektim të procedurave ligjore të zbatueshme dhe veçanërisht në respektim të të drejtave të garantuara të zbatueshme për bashkëpunëtorin në fjalë.

Ndëshkime të tilla, në respektim të ligjit të zbatueshëm, mund të përfshijnë veçanërisht pushimin nga puna për shkak gabimi dhe kërkesa për dëmshpërblim me iniciativën e VINCI-t, edhe nëse mosrespektimi i rregullave është zbuluar nga vetë Grupi në kuadrin e një kontrolli të brendshëm.

Secili duhet të jetë vigjilent për zbatimin
siç duhet të kartës së etikës nga ai vetë,
por edhe ata përreth tij, ose ndaj personave
që janë nën përgjegjësinë e tij.



R E A L
SUCCESS
I S T H E
SUCCESS
YOU SHARE

VINCI

1973, boulevard de La Défense
CS 10268
F-92757 Nanterre Cedex
Tel.: +33 1 57 98 61 00
www.vinci.com

